



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. _____ Prot.

Vlorë më, 26. 12. 2018

VENDIM

Nr. 41, datë 26. 12. 2018

**PER MIRATIMIN E BURSAVE DHE PERJASHTIMET NGA TARIFA PER
STUDENTET TE CILET JANE PRANUAR NE NJE PROGRAM TE CIKLIT TE
PARE TE STUDIMEVE NE NJE PROGRAM TE INTEGRUAR TE STUDIMEVE
OSE NE NJE PROGRAM TE STUDIMEVE PROFESIONALE**

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 49 pika 1, gërma a, VKM Nr. 903, datë 21.12.2016 "Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë", i ndyshuar, VKM Nr. 269, datë 29.03.2017 "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkolimit", Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 26.12. 2018

VENDOSI

1. Të miratojë bursat e studimit për studentët e ciklit të parë të studimeve për vitin akademik 2018- 2019 sipas tabelës bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Të miratojë përjashtimet nga tarifa për vitin akademik 2018- 2019 sipas tabelës për përjashtimet bashkëngjitur këtij vendimi
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Administratori dhe Drejtorja e Shërbimeve Mbështetëse e Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Dr.Rezana Vrapì- Kryetare

Eduard Ahmeti - Anëtar

Ornela Koleka- Anëtar

Dr. Elsajed Rexhaj- Anëtar

Dr. Enida Pulaj- Anëtar

Dr. Marinela Muço- Anëtar